




# Kanceri i prostatës

## Karcinoma e prostatës



### Prostata

Prostata është një gjëndër me madhësi gështenje, e cila tek burrat është e vendosur nën fshikën e urinës. Pjesa e sipërme e fshikës së urinës e përshkon mespërmes prostatën. Në prostatë prodhohet një lëng (sekrecion), i cili në rastin e hedhjes së farës (ejakulimit) rrjedh bashkë me spermën dhe kujdeset që të mbeten të lëvizshme spermatozoidet.

Prostata përbëhet kryesisht nga inde gjëndërore. Nga këto gjëndëra mund të krijohet kanceri i prostatës.

### Incidenca

Në Zvicër brenda një viti nga kanceri i prostatës sëmurën afro 5600 burra. Kësisoj, kanceri i prostatës përfaqëson llojin më të shpeshtë të kancerit në përgjithësi: 30% e të gjithë burrave të sëmurë nga kanceri vuajnë nga kanceri i prostatës. Kanceri i prostatës është një «kancer tipik i pleqërisë». Pothuajse të gjithë pacientët janë mbi-50-vjeçarë, 60% syresh madje mbi 70 vjeç.

Vlerësohet se qelizat e kancerit të prostatës janë të pranishme tek afro gjysma e të gjithë burrave mbi 75-vjeçarë. Mirëpo shumica e këtyre burrave as që e ndjejnë ndonjëherë tumorin, pasi që nuk është aq i madh sa të mund të shkaktojë shqetësime.

### Simptoma

Shumica e tumorëve në prostatë për një kohë të gjatë nuk shkaktojnë shqetësime ose shkaktojnë vetëm shqetësime të vogla. Për këtë shkak kanceri i prostatës relativisht shpesh zbulohet në kuadër të ndonjë ekzaminimi për zbulim të hershëm, atëherë kur personi i prekur akoma nuk ndjen shqetësime.

Në rast se tumori është aq i madh, sa që e ka ngushtuar uretrën (ujëhollënxjerrësin), mund të paraqiten probleme gjatë urinimit, për shembull:

- > Rrjedhë e dobët e urinës
- > Presion i shpeshtë për urinim
- > Dhimbje ose vështirësi të tjera gjatë urinimit
- > Gjaku në urinë

Gjithsesi, shqetësime të tilla paraqiten shpesh tek burrat e moshuar, edhe pa prezencën e kancerit në prostatë. Në shumicën e rasteve ato shkaktohen nga ndonjë zmadhim natyremirë i prostatës.

### Diagnozat dhe ekzaminimet

Për diagnostifikimin e kancerit në prostatë zbatohen ekzaminime të ndryshme:

- > Kontroll daktilik i prostatës: një pjesë e prostatës mund të kontrollohet me gishtërinj përmes rektumit (ekzaminim digjital rektal). Po qe se mjeku

(urologu) do të zbulojë kështu ndonjë nyje të fortë ose të vrazhdë, kjo mund të jetë indikacion i kancerit në prostatë.

- > Përcaktimi i vlerës PSA në gjak (Testi PSA): antigjeni i specifik i prostatës (PSA) është një proteinë që prodhohet vetëm në prostatë. Një vlerë e shtuar e PSA mundet – mirëpo jo domosdoshmërisht – që të jetë shkaktuar nga kanceri në prostatë.
- > Biopsia e prostatës: në rastin e këtij ekzaminimi mjeku përmes një gjilpëre do të marrë inde të ndryshme për provë nga prostata. Këto do të kontrollohen nën mikroskop për prani qelizash malinje.
- > Ultratingulli i prostatës: përmes ultratingullit mund të përcaktohet madhësia e prostatës dhe përhapja e ndonjë tumori të mundshëm.

Për të konstatuar nëse, dhe në ç'masë, është përhapur tumori në organizëm, sipas rrethanash do të ndërmerren ekzaminime të mëtejshme, për shembull një scintigrafi e kockave ose një tomografi kompjuterike.

### Stadeti e sëmundjes

Sëmundjet kanceroze ndahen sipas sistemit TNM. Me këtë rast gjykohet përhapja e tumorit (T), invadimi i nyjave limfatike (N) dhe eventualisht metastazat e pranishme (M). Kanceri i prostatës ndahet si vijon:

<b>T0</b>	S'ka prezencë tumori
<b>T1</b>	Tumori është i kufizuar në prostatë dhe është i provueshëm vetëm përmes mikroskopit
<b>T2</b>	Tumori është i kufizuar në prostatë
<b>T3</b>	Tumori ka depërtuar sipër qeskës së prostatës
<b>T4</b>	Tumori ka infiltruar organet fqinje
<b>Tx</b>	Për përhapjen e tumorit nuk mund të gjykohet dot
<b>N0</b>	Nuk ka invadim nyjash limfatike
<b>N1</b>	Tumori ka invaduar nyjat limfatike në legen
<b>Nx</b>	Invadimi i nyjave limfatike nuk mund të gjykohet
<b>M0</b>	Nuk ka metastaza
<b>M1</b>	Metastaza në organet tjera (për shembull në kocka)
<b>Mx</b>	Nuk mund të gjykohet për prani metastazash

Në bazë të provave të indeve nga kanceri në prostatë do të përcaktohet dhe «Gleason Score». Ky tregues numerik prej 2 deri në 10 tregon se me ç'shpjëtësi është duke u rritur tumori, për shembull:

- > Një Gleason-Score nr. 3 nënkupton një rritje të ngadalshme (tumor relativisht natyrëmirë)
- > Një Gleason-Score nr. 9 nënkupton një rritje të shpejtë (tumor agresiv).

### Terapia

Parimisht, në dispozicion janë metoda të ndryshme terapeutike. Ato përdoren të vetme ose të kombinuara:

- > «Duke parë e duke pritur» (watchful waiting): Në situata të caktuara, kur tumori nuk rritet në mënyrë agresive dhe nuk shkakton ndonjë shqetësim, fillimisht nuk ka nevojë për terapi. Pacienti dhe zhvillimi i tumorit do të ekzaminohet prej mjekut në etapa të rregullta kohore. Ky opsion vjen në shprehje në radhë të parë tek burrat më të moshuar se 75 vjeç.

- > Operacioni: prostata dhe nyjat limfatike që gjenden në afërsi do të hiqen.
- > Rrezatimi nga jashtë (radioterapia perkutane): prostata do të rrezatohet nga jashtë për të eliminuar qelizat kanceroze.
- > Rrezatimi nga brenda (brachyterapia): nën efektin e narkozës, burimi i rrezatimit do të plasohet direkt në prostatë, me qëllim që kjo të rrezatohet nga afërsia direkte.
- > Terapia anti-hormonale: hormoni seksual mashkullor, testosteroni, nxit rritjen e qelizave kanceroze. Ndikimi i testosteronit do të frenohet përmes medikamentesh të caktuara. Për dallim nga e kaluara, sot nuk hiqen më herdhet për të ndërprerë prodhimin e testosteronit.
- > Kimioterapia: përmes kimioterapisë do të ngadalësohet rritja e mëtejshme e tumorit. Një kimioterapi vjen në shprehje vetëm në stadi të avancuara të kancerit në prostatë.

Plani i trajtimit tek kanceri në prostatë varet nga faktorë të ndryshëm, për shembull, nga mosha dhe nga gjendja shëndetësore e pacientit, nga përmasat e shqetësimeve, nga përhapja e tumorit dhe agresiviteti i tij (Gleason-Score).

### Pasoja të trajtimit

Prostata luan një rol të rëndësishëm tek seksualiteti, përkatësisht, tek barrësimi (fekondimi). Pas një operacioni ose radioterapie, meshkujt e prekur nuk mund të ngjizin më dot fëmijë. Mund të kufizohet edhe aftësia për ereksion, ajo madje mund të humbet plotësisht (Impotencia ose disfunzioni erektil).

Terapia e kancerit në prostatë jo rrallë mund të çojë edhe në inkontinencë urinare (rrjedhje e pakontrollueshme e urinës). Nuk mund të parashikohet dot përpara fillimit të trajtimit nëse do të paraqitet një inkontinencë urinare, se sa e rëndë do të jetë ajo dhe nëse kontinenca do të rinormalizohet në muajt pas ndërhyrjes.

### Paskontrollet

Pas përfundimit të trajtimit nga kanceri, pacientët duhet ta vizitojnë rregullisht mjekun e tyre për kontrole gjatë përkujdesjes shëndetësore të mëpasme. Ai do t'i japë secilit pacient rekomandime individuale se cilat ekzaminime në cilin hark kohor janë të domosdoshme.

### Faktorët rrezikues dhe parandalimi

Dy faktorë shtojnë rrezikun nga kanceri i prostatës.

Në rast se një familjar i afërm, si babai, vëllai ose djali, është i sëmurë nga kanceri në prostatë, eventualisht mund të ekzistojë një predispozitë trashëgimore; kështu edhe rreziku vetjak është më i lartë. Faktori i dytë rrezikues ka të bëjë me moshën: sa më i moshuar të jetë një burrë, aq më i lartë është rrezikimi i tij nga kanceri në prostatë.

Nuk janë të njohura masat me të cilat do të mund të parandalohet kanceri i prostatës.

## Zbulimi i hershëm

Për zbulimin e hershëm të kancerit në prostatë janë në dispozicion dy metoda: shqyrtimi daktilik i prostatës përmes zorrës së trashë (ekzaminimi rektal digital, DRU) dhe/ose përcaktimi i vlerës së PSA në gjak (Test PSA).

DRU është një ekzaminim shumë i pasaktë: vetëm 20 në 100 tumorë prostatash mund të hetohen përmes DRU.

Testi PSA përbën një metodë ekzaminimi të thjeshtë, të shpejtë dhe të lirë. Gjithsesi, një vlerë e rritur e PSA

nuk nënkupton akoma që një mashkull ta ketë kancerin në prostatë. Në rastin e shtimit të një vlere të PSA duhen ndërmarrë ekzaminime të mëtejshme, sipas rregullit, marrja e indeve për provë nga prostata (biopsia).

Në botën profesionale mjekësore momentalisht nuk ka unitet për sa i përket faktit nëse dhe në cilën formë do të rekomandohen masat për një zbulim të hershëm. Është e arsyeshme që përpara marrjes së vendimit pro ose kundër ekzaminimeve për zbulim të hershëm të jemi të informuar mirë lidhur me të mirat dhe të këqijat e tyre dhe të këshillohemi me mjekun.

## Shënim

Ky informacion mund të shkarkohet nga [www.krebsliga.ch](http://www.krebsliga.ch) → Krebskrankheiten (Sëmundjet kanceroze) edhe në gjuhët gjermanisht, frëngjisht, italisht, spanjisht, portugalisht, serbisht-kroatisht-boshnjakisht dhe turqisht. Mos harroni dhe broshurat tona falas në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht nën [www.krebsliga.ch/broschueren](http://www.krebsliga.ch/broschueren).

## Informacion, Këshillim, Mbështetje

### Krebsliga Aargau

Tel. 062 834 75 75  
[www.krebsliga-aargau.ch](http://www.krebsliga-aargau.ch)

### Krebsliga beider Basel

Tel. 061 319 99 88  
[www.krebsliga-basel.ch](http://www.krebsliga-basel.ch)

### Bernische Krebsliga Ligue bernoise contre le cancer

Tel. 031 313 24 24  
[www.bernischekrebssliga.ch](http://www.bernischekrebssliga.ch)

### Ligue fribourgeoise contre le cancer

**Krebsliga Freiburg**  
tél. 026 426 02 90  
[www.liguecancer-fr.ch](http://www.liguecancer-fr.ch)

### Ligue genevoise contre le cancer

tél. 022 322 13 33  
[www.lgc.ch](http://www.lgc.ch)

### Krebsliga Glarus

Tel. 055 646 32 47  
[www.krebsliga-glarus.ch](http://www.krebsliga-glarus.ch)

### Krebsliga Graubünden

Tel. 081 252 50 90  
[www.krebsliga-gr.ch](http://www.krebsliga-gr.ch)

### Ligue jurassienne contre le cancer

tél. 032 422 20 30  
[www.liguecancer-ju.ch](http://www.liguecancer-ju.ch)

### Ligue neuchâteloise contre le cancer

tél. 032 721 23 25  
[www.liguecancer-ne.ch](http://www.liguecancer-ne.ch)

### Krebsliga Schaffhausen

Tel. 052 741 45 45  
[www.krebsliga-sh.ch](http://www.krebsliga-sh.ch)

### Krebsliga Solothurn

Tel. 032 628 68 10  
[www.krebsliga-so.ch](http://www.krebsliga-so.ch)

### Krebsliga St. Gallen- Appenzell

Tel. 071 242 70 00  
[www.krebsliga-sg.ch](http://www.krebsliga-sg.ch)

### Thurgauische Krebsliga

Tel. 071 626 70 00  
[www.tgkl.ch](http://www.tgkl.ch)

### Lega ticinese contro il cancro

tel. 091 820 64 20  
[www.legacancro-ti.ch](http://www.legacancro-ti.ch)

### Ligue valaisanne contre le cancer

tél. 027 322 99 74  
[www.lvcc.ch](http://www.lvcc.ch)

### Krebsliga Wallis

Tel. 027 922 93 21  
[www.krebsliga-wallis.ch](http://www.krebsliga-wallis.ch)

### Ligue vaudoise contre le cancer

tél. 021 641 15 15  
[www.lvc.ch](http://www.lvc.ch)

### Krebsliga Zentralschweiz

Tel. 041 210 25 50  
[www.krebsliga.info](http://www.krebsliga.info)

### Krebsliga Zug

Tel. 041 720 20 45  
[www.krebsliga-zug.ch](http://www.krebsliga-zug.ch)

### Krebsliga Zürich

Tel. 044 388 55 00  
[www.krebsliga-zh.ch](http://www.krebsliga-zh.ch)

### Krebshilfe Liechtenstein

Tel. 00423 233 18 45  
[www.krebshilfe.li](http://www.krebshilfe.li)

### Krebstelefon / Ligne Info- Cancer / Linea cancro

0800 11 88 11  
Nga e hëna në të premten,  
ora 10–18. Gjermanisht,  
frëngjisht, italisht; falas

### migesplus

Schweizerisches Rotes Kreuz  
3084 Wabern  
Tel. 031 960 75 71  
[www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch)  
Informacione për migrante  
dhe migrantë

## Impressum

### Autore

Dr. med. Eva Ebnöter,  
Zollikon

### Përkthimi

Bislim Elshani, migesplus

### Ilustrimet

Daniel Haldemann, Wil SG

### Botues

Krebsliga Schweiz  
Effingerstrasse 40  
Postfach 8219  
3000 Bern  
Telefon 031 389 91 00  
[www.krebsliga.ch](http://www.krebsliga.ch)

© 2010

Krebsliga Schweiz, Bern